<p>kërkimore dhe specifikat tjera matëse që dërgojnë në caktimin e lartësisë së buxhetit specifikohen në shtojcën e parë të këtij udhëzimi.</p>	<p>projects and other measurement specifications that lead in setting the height of the budget are specified in the first appendix of this instruction.</p>	<p>projekata i druge merne specifikacije koje dovode do raspodele visine budžeta su specifikovane u prvom prilogu ovog uputstva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 20</b> <b>Numri i publikimeve shkencore</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 20</b> <b>Number of scientific publications</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 20</b> <b>Broj naučnih publikacija</b></p>
<p>1. Publikim shkencor konsiderohet libri mësimor, monografia shkencore, punimi shkencor në revista vendore apo ndërkombëtare dhe kontributet tjera shkencore.</p>	<p>1. A scientific publication is considered a textbook, a scientific monograph, a scientific paper in local or international journals and other scientific contributions.</p>	<p>1. Naučnom publikacijom se smatra udžbenik, naučna monografija, naučni rad u domaćim ili međunarodnim časopisima i drugi naučni doprinosi.</p>
<p>2. Për qëllim të këtij udhëzimi, punim shkencor në revista ndërkombëtare llogaritet punimi i cili sipas standardeve të akreditimit është i publikuar në ndonjërin nga platformat e aplikueshme si në vijim:</p>	<p>2. For the purpose of this instruction, a scientific paper in an international journal is considered a paper which, according to the accreditation standards, is published in any of the applicable platforms as follows:</p>	<p>2. Za potrebe ovog uputstva, naučni rad u međunarodnom časopisu smatra se rad koji je, prema standardima akreditacije, objavljen na bilo kojoj od važećih platformi i to:</p>
<p style="padding-left: 40px;">2.1. Web of Science (në ndonjërin prej koleksioneve bërthamë: SCIE, SSCI, AHCI);</p>	<p style="padding-left: 40px;">2.1. Web of Science (in any of the core collections: SCIE, SSCI, AHCI);</p>	<p style="padding-left: 40px;">2.1. Web of Science (u bilo kojoj od osnovnih kolekcija: SCIE, SSCI, AHCI);</p>
<p style="padding-left: 40px;">2.2. Scopus (Elsevier).</p>	<p style="padding-left: 40px;">2.2. Scopus (Elsevier).</p>	<p style="padding-left: 40px;">2.2. Scopus (Elsevier).</p>
<p>3. Për qëllim të këtij udhëzimi, punim shkencor në revista vendore, llogaritet punimi i cili është i publikuar në ndonjë revistë shkencore në Kosovë.</p>	<p>3. For the purpose of this instruction, a scientific paper in local journals is considered a paper which is published in any of scientific journals in Kosova:</p>	<p>3. Za potrebe ovog uputstva, naučni rad u domaćim časopisima smatra se rad koji je, prema standardima objavljenim u bilo kom naučnom časopisu na Kosovo.</p>
<p>4. Institucioni publik i arsimit të lartë në</p>	<p>4. At the beginning of each calendar year,</p>	<p>4. Javna institucije visokog obrazovanja na</p>

<p>fillim të secilit vit kalendarik përgatit raport përmbledhës lidhur me numrin e publikimeve të stafit akademik dhe planin e publikimeve shkencore për vitin vijues.</p> <p>5. Me rastin e negocimit të marrëveshjes së performancës, raporti nga paragrafi 4 (katër) përfshin të dhënat nga 3 (tre) vitet e fundit.</p> <p>6. Mënyra e llogaritjes së publikimeve shkencore në revista vendore dhe ndërkombëtare dhe specifikat tjera matëse që dërgojnë në caktimin e lartësisë së buxhetit specifikohen në shtojcën e parë të këtij udhëzimi.</p>	<p>the public institution of higher education prepares a summary report regarding the number of publications of the academic staff and and the plan of scientific publications for the next year.</p> <p>5. When negotiating the performance agreement, the report from paragraph 4 (four) includes the data from the last 3 (three) years.</p> <p>6. The method of calculating scientific publications in local and international journals and other measurement specifications that lead in setting the height of the budget are specified in the first appendix of this instruction.</p>	<p>početku svake kalendarske godine priprema zbirni izveštaj o broju publikacija akademskog osoblja i plan naučnih publikacija za narednu godinu.</p> <p>5. Prilikom ugovaranja sporazuma o performansi, izveštaj iz stava 4 (četiri) obuhvata podatke za poslednje 3 (tri) godine.</p> <p>6. Način izračunavanja naučnih publikacija u domaćim međunarodnim časopisima i druge merne specifikacije koje dovode do raspodele visine budžeta su specifikovane u prvom prilogu ovog uputstva.</p>
<p style="text-align: center;"><b>VI. MARRËVESHJA E PERFORMANCËS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 21</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Pajtueshmëria me strategjitë zhvillimore dhe forma e marrëveshjes</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>VI. PERFORMANCE AGREEMENT</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 21</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Compliance with development strategies and the form of agreement</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>VI. SPORAZUM O PERFORMANSI</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 21</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Uskladenost sa razvojnim strategijama i oblikom sporazuma</b></p>
<p>1. Marrëveshja e performancës duhet të jetë në pajtueshmëri me indikatorët e caktuar me këtë udhëzim dhe me strategjinë zhvillimore të universitetit, e cila sipas nevojës mund të rishikohet nga institucioni publik i arsimit të lartë para nënshkrimit të çdo marrëveshjeje të performancës.</p>	<p>1. The performance agreement must be in compliance with the indicators set by this instruction and with the development strategy of the university, which can be reviewed by the public institution of higher education before signing any performance agreement.</p>	<p>1. Sporazum o performansi mora biti u skladu sa pokazateljima utvrđenim ovim uputstvom i sa strategijom razvoja univerziteta, koji se prema potrebi može revidirati od strane svake institucije visokog obrazovanja pre potpisivanja bilo kakvog sporazuma o performansi.</p>



<p>2. Marrëveshja e performancës lidhet në formë të shkruar.</p>	<p>2. The performance agreement is concluded in written form.</p>	<p>2. Sporazum o performansi se zaključuje u pisanoj formi.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 22</b> <b>Kohëzgjatja e marrëveshjes</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 22</b> <b>Duration of the agreement</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 22</b> <b>Trajanje sporazuma</b></p>
<p>Marrëveshja e performancës lidhet për një periudhë (3) trevjeçare në pajtueshmëri me Ligjin për Arsimin e Lartë.</p>	<p>The performance agreement is concluded for a period of 3 (three) years in compliance with the Law on Higher Education.</p>	<p>Sporazum o performansi zaključuje se na period od 3 (tri) godine u skladu sa Zakonom o visokom obrazovanju.</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 23</b> <b>Përmbajtja e marrëveshjes</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 23</b> <b>Content of the agreement</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 23</b> <b>Sadržaj sporazuma</b></p>
<p>1. Marrëveshja përmban pjesët si në vijim:</p> <p>1.1. Identifikimin e palëve;</p> <p>1.2. Kohëzgjatjen;</p> <p>1.3. Kushtet e përgjithshme dhe të veçanta;</p> <p>1.4. Vlerën e buxhetit për secilin vit dhe vlerën totale të buxhetit për periudhën (3) trevjeçare;</p> <p>1.5. Përshkrimin e fushave të performancës;</p> <p>1.6. Mënyrën dhe afatet e mbikëqyrjes;</p> <p>1.7. Mundësinë e rishikimit të buxhetit;</p>	<p>1. The agreement contains the following parts:</p> <p>1.1. Identification of parties;</p> <p>1.2. Duration;</p> <p>1.3. General and specific conditions;</p> <p>1.4. The budget value for each year and the total value of the budget for the period of 3 (three) years;</p> <p>1.5. Description of performance areas;</p> <p>1.6. Manner and deadlines of supervision;</p> <p>1.7. Possibility of budget review;</p>	<p>1. Sporazum sadrži sledeće delove:</p> <p>1.1. Identifikacija stranaka;</p> <p>1.2. Trajanje;</p> <p>1.3. Opšti i posebni uslovi;</p> <p>1.4. Vrednost budžeta za svaku godinu i ukupna vrednost budžeta za period od 3 (tri) godine;</p> <p>1.5. Opis oblasti performanse</p> <p>1.6. Način i rokovi nadzora;</p> <p>1.7. Mogućnost revizije budžeta;</p>

<p>1.8. Mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;</p> <p>1.9. Nënshkrimin e palëve.</p> <p>2. Pavarësisht nga paragrafi 1, marrëveshja mund të përmbajë edhe elemente tjera në pajtueshmëri me këtë udhëzim dhe me qëllim të implementimit sa më efektiv.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 24</b> <b>Negocimi i marrëveshjes</b></p> <p>1. Marrëveshja e performancës negociohet nga Ministria dhe institucioni i arsimit të lartë në bashkëpunim me MFPT.</p> <p>2. Institucioni i arsimit të lartë propozon një marrëveshje të performancës e cila është objekt negocimi me MASHTI. Gjatë negocimit të marrëveshjes vlerësohen edhe arritjet e objektivave nga marrëveshja paraprake (3) trevjeçare.</p> <p>3. Gjatë negocimit të marrëveshjes, Ministrinë e përfaqëson Ministri apo i deleguari i tij. Institucionin publik të arsimit të lartë e përfaqëson Rektori apo i deleguari i tij.</p>	<p>1.8. Method of resolving disputes;</p> <p>1.9. Signature of the parties.</p> <p>2. Regardless of paragraph 1, the agreement may also contain other elements in compliance with this instruction and in order to implement it as effectively as possible.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 24</b> <b>Negotiation of the agreement</b></p> <p>1. The performance agreement is negotiated by the Ministry and the institution of higher education in cooperation with MFLT.</p> <p>2. The higher education institution proposes a performance agreement which is subject to negotiation with MESTI. During the negotiation of the agreement, the achievements of the objectives from the preliminary 3 (three) year agreement are also evaluated.</p> <p>3. During the negotiation of the agreement, the Ministry is represented by the Minister or its representative. Public institution of higher education represented by the Rector or its representative.</p>	<p>1.8. Način rešavanja sporova;</p> <p>1.9. Potpisivanje stranaka.</p> <p>2. Bez obzira na stav 1., sporazum može sadržati i druge elemente u skladu sa ovim uputstvom i u cilju što efikasnijeg njegovog sprovođenja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 24</b> <b>Pregovaranje o sporazumu</b></p> <p>1. Sporazum o performansi dogovaraju Ministarstvo i institucija visokog obrazovanja u saradnji sa MFRT.</p> <p>2. Institucija visokog obrazovanja predlaže sporazum o performansi koji je predmet pregovora sa MONTI. Tokom pregovora o sporazumu, takođe se ocenjuje dostignuće objekta iz preliminarnog sporazuma 3 (tri) godine.</p> <p>3. Tokom pregovora o sporazumu, Ministarstvo predstavlja ministar ili njegov delegirani. Javnu instituciju visokog obrazovanja predstavlja rektor ili njegov delegirani.</p>
---	--	--

<p>4. Marrëveshja negociohet gjatë periudhës kohore janar-mars të vitit paraprak kalendarik para se marrëveshja të filloj të implementohet.</p> <p>5. Marrëveshja e parë (3) trevjeçare 2026-2028, negociohet gjatë periudhës kohore janar-mars të vitit 2025.</p>	<p>4. The agreement is negotiated during the January-March time period of the previous calendar year before the agreement begins to be implemented.</p> <p>5. The first 3 (three) year agreement 2026-2028 is negotiated during the time period January-March 2025.</p>	<p>4. Sporazum se pregovara u periodu januar-mart prethodne kalendarske godine pre nego što sporazum počne da se primenjuje..</p> <p>5. Prvi 3 (trogodišnji) sporazum 2026-2028 se pregovara u vremenskom periodu januar-mart 2025.</p>
<p><b>Neni 25</b> <b>Miratimi i marrëveshjes</b></p>	<p><b>Article 25</b> <b>Approval of the agreement</b></p>	<p><b>Član 25</b> <b>Usvajanje sporazuma</b></p>
<p>1. Marrëveshja miratohet përmes konfirmimit me shkrim nga Ministri dhe Rektori.</p> <p>2. Konfirmimi me shkrim nga paragrafi 1 (një) nënkupton komunikimin me shkrim ndërmjet Ministrin dhe Rektorit lidhur me pajtueshmërinë e plotë lidhur me përmbajtjen e marrëveshjes.</p> <p>3. Ministri në një proces konsultues të brendshëm siguron pëlqim nga MFPT dhe Zyra e Kryeministrit para konfirmimit të cekur në paragrafin 1 (një) të këtij neni.</p> <p>4. Rektori i institucionit publik të arsimit të lartë në një proces konsultimi të brendshëm siguron pëlqim nga senati dhe këshilli</p>	<p>1. The agreement is approved through written confirmation from the Ministry and Rector.</p> <p>2. Written confirmation from paragraph 1 (one) means written communication between the Minister and the Rector regarding full compliance with the content of the agreement.</p> <p>3. The Minister in an internal consultative process obtains consent from the MFLT and the Prime Minister's Office before the confirmation referred to in paragraph 1 (one) of this article.</p> <p>4. The rector of the public higher education in an internal consultative process obtains consent from the Senate and the</p>	<p>1. Sporazum se odobrava pismenim potvrđivanjem od strane ministra i rektora.</p> <p>2. Pisano potvrđivanje iz stava 1. (prvi) podrazumeva pismenu komunikaciju između ministra i rektora o potpunoj usklađenosti sa sadržajem sporazuma.</p> <p>3. Ministar u internom konsultativnom postupku obezbeđuje saglasnost od MFRT i Kancelarije premijera pre potvrde navedene u stav 1. (prvi) ovog člana.</p> <p>4. Rektor javne institucije visokog obrazovanja u internom konsultativnom procesu obezbeđuje saglasnost Senata i</p>

<p>drejtues para konfirmimit të cekur në paragrafin 1 (një) të këtij neni.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 26</b> <b>Nënshkrimi i marrëveshjes</b></p> <p>1. Pas miratimit nga neni paraprak, Ministri dhe Rektori në mënyrë solemne dhe njëkohësisht nënshkruajnë marrëveshjen e performancës.</p> <p>2. Marrëveshja e performancës nuk është ligjërish e obligueshme pa nënshkrimin e palëve kontraktuale nga paragrafi 1 (një) i këtij neni.</p> <p>3. Në rastet kur për ndonjë arsye të bazuar Ministri apo Rektori refuzojnë të nënshkruajnë marrëveshjen e performancës, atëherë buxhetimi i universitetit negociohet nga një përfaqësues i deleguar nga Konferenca e Rektorëve, një përfaqësues i deleguar nga Zyra e Kryeministrit dhe një përfaqësues i deleguar nga MFPT.</p> <p>4. Përfaqësuesit e institucioneve nga paragrafi 3 (tre) paraqesin propozim për Ministrin dhe Rektorin. Ky propozim duhet të bazohet në parimin e ligjshmërisë, objektivitetit dhe të ketë parasysh mundësinë reale të realizimit të objektivave të synuara</p>	<p>Steering Council before the confirmation referred to in paragraph 1 (one) of this article.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 26</b> <b>Signing the agreement</b></p> <p>1. After approval from the preliminary article, the Minister and the Rector solemnly and simultaneously sign the performance agreement.</p> <p>2. The performance agreement is not legally binding without the signature of the contractual parties from paragraph 1 (one) of this article.</p> <p>3. In cases where, for any reason, the Minister or Rector refuses to sign the performance agreement, then the university's budgeting is negotiated by a representative authorized by the Rectors' Conference, a representative authorized by the Prime Minister's Office and a representative authorized by MFLT.</p> <p>4. The representatives of the institutions from paragraph 3 (three) present a proposal to the Minister and the Rector. This proposal should be based on the principle of legality, objectivity and take into account the real possibility of achieving the intended</p>	<p>Upravnog veća pre potvrđivanja navedenim u stav 1. (prvi) ovog člana.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 26</b> <b>Potpisivanje sporazuma</b></p> <p>1. Nakon saglasnosti iz prethodnog člana, ministar i rektor svečano i istovremeno potpisuju sporazum o performansi.</p> <p>2. Sporazum o performansi nije pravno obavezujući bez potpisa ugovornih strana iz stav 1. (prvi) ovog člana.</p> <p>3. U slučajevima kada iz bilo kog razloga ministar ili rektor odbiju da potpišu sporazum o performansi, onda o budžetiranju univerziteta pregovara predstavnik koga delegira Konferencija rektora, jedna predstavnik koga delegira Kancelarija premijera i predstavnik koga delegira MFRT.</p> <p>4. Predstavnici institucija iz stava 3 (tri) iznose predlog ministru i rektoru. Ovaj predlog treba da bude zasnovan na principu zakonitosti, objektivnosti i da uzme u obzir realnu mogućnost postizanja zacrtanih ciljeva univerziteta.</p>
--	--	---

<p>të universitetit. 5. Ministri dhe Rektori duhet të marrin në konsideratë propozimin nga paragrafi paraprak.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 27</b> <b>Rishikimi i marrëveshjes me qëllim të rritjes së buxhetit në bazë të performancës</b></p> <p>1. MASHTI mund të rishikoj marrëveshjen sipas kërkesës së institucionit të arsimit të lartë me qëllim të rritjes së buxhetit.</p> <p>2. Institucioni publik i arsimit të lartë mund të paraqes kërkesën nga paragrafi 1 (një) vetëm nëse progresi është qartazi i matshëm.</p> <p>3. Kërkesa nga paragrafi 1 mund të paraqitet vetëm pas zbatimit të marrëveshjes për një periudhë 18 (tetëmbëdhjetë) mujore.</p> <p>4. Nëse MASHTI miraton kërkesën nga ky nen, atëherë nënshkruhet aneksi i marrëveshjes bazike.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Mbikëqyrja dhe auditimi i marrëveshjes</b></p> <p>1. MASHTI, mbikëqyrë implementimin e</p>	<p>objectives of the university. 5. The Minister and the Rector must consider the proposal from the previous paragraph.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 27</b> <b>Review of the agreement in order to increase the performance-based budget</b></p> <p>1. MESTI can review the agreement at the request of the higher education institution in order to increase the budget.</p> <p>2. The public institution of higher education can submit the request from paragraph 1 (one) only if the progress is clearly measurable.</p> <p>3. The request from paragraph 1 can be presented only after the implementation of the agreement for a period of 18 (eighteen) months.</p> <p>4. If MESTI approves the request from this Article, then the basic agreement annex is signed.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Supervision and audit of the agreement</b></p> <p>1. MESTI supervises the implementation of</p>	<p>5. Ministar i rektor moraju razmotriti predlog iz prethodnog stava.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 27</b> <b>Razmatranje sporazuma u cilju povećanje budžeta na osnovu performanse</b></p> <p>1. MONTI može preispitati sporazum na zahtev institucije visokog obrazovanja radi povećanja budžeta.</p> <p>2. Javna institucija visokog obrazovanja može da podnese zahtev iz stava 1 (jedna) samo ako je napredak jasno merljiv.</p> <p>3. Zahtev iz stava 1. može se podneti tek nakon sprovođenja sporazuma u trajanju od 18 (osamnaest) meseci.</p> <p>4. Ukoliko MONTI odobri zahtev iz ovog člana, onda se potpisuje aneks osnovnog sporazuma.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Praćenje i revizija sporazuma</b></p> <p>1. MONTI kontinuirano nadgleda</p>
---	---	---

<p>marrëveshjes në mënyrë të vazhdueshme.</p> <p>2. Njësia përgjegjëse brenda MASHTI, bën mbikëqyrjen e marrëveshjes.</p> <p>3. Buxheti i financuar në bazë të marrëveshjes së performancës, i nënshtrohet auditimit të brendshëm dhe të jashtëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.</p> <p style="text-align: center;"><b>VII. PËRAFRIMI ME AGJENCINË E KOSOVËS PËR AKREDITIM</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b> <b>Bashkëpunimi ndërinstitucional</b></p> <p>MASHTI bashkëpunon me AKK në procesin e shkëmbimit të informatave që kanë rëndësi në buxhetimin e institucioneve publike të arsimit të lartë.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Bashkëpunimi me AKK</b></p> <p>Institucionet publike të arsimit të lartë duhet që pa marrë parasysh marrëveshjen e performancës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të plotësuar kërkesat e caktuara nga AKK.</p>	<p>the agreement on an ongoing basis.</p> <p>2. The responsible unit within MESTI supervises the agreement.</p> <p>3. The budget financed on the basis of the performance agreement is subject to internal and external audit determined by the legislation in force.</p> <p style="text-align: center;"><b>VII. APPROXIMATION TO THE KOSOVA ACCREDITATION AGENCY</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 29</b> <b>Inter-institutional cooperation</b></p> <p>MASHTI cooperates with NQA in the process of exchanging information that is important in the budgeting of public institutions of higher education.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Cooperation with NQA</b></p> <p>Public institutions of higher education must, regardless of the performance agreement, take the necessary actions to meet the requirements set by NQA.</p>	<p>sprovođenje sporazuma.</p> <p>2. Odgovorna jedinica u okviru MONTI-a nadgleda sporazum.</p> <p>3. Budžet finansiran prema sporazumu o performansi podleže internoj i eksternoj reviziji utvrđenoj važećim zakonima.</p> <p style="text-align: center;"><b>VII. APROKSIMACIJA SA KOSOVSKOM AGENCIJOM ZA AKREDITACIJU</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 29</b> <b>Međuinstitucionalna saradnja</b></p> <p>MONTI saraduje sa KAA u procesu razmene informacija koje su važne u budžetiranju javnih institucija visokog obrazovanja.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Saradnji sa KAA</b></p> <p>Javne institucije visokog obrazovanja treba da, bez obzira na sporazum o performansi, preduzmu neophodne radnje da ispune zahteve koje odredi KAA.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Zbatimi i këtij udhëzimi</b></p> <p>1. Ky udhëzim në tërësi fillon të zbatohet në vitin 2025.</p> <p>2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 (një), për vitin 2024 lidhet marrëveshje provuese (1) njëvjeçare ndërmjet Ministrisë dhe institucionit publik të arsimit të lartë me qëllim që të krijohet praktika dhe modalitetet e nevojshme për funksionimin efektiv të metodologjisë së re të financimit.</p> <p>3. Marrëveshja nga paragrafi 2 (dy) lidhet në pajtueshmëri me dispozitat e këtij Udhëzimi por që nuk cenon shumën e buxhetit të ndarë nga Ligji për Buxhetin për vitin 2024.</p> <p>4. Negocimi për lidhjen e marrëveshjes nga paragrafi 2 (dy) realizohet pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi dhe duke pasur për bazë afatet dhe planifikimet përgatitore buxhetore për vitin 2024.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Zbatimi i legjislacionit tjetër në fuqi</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>VIII. TRANSITIONAL AND FINAL PROVISIONS</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Implementation of this instruction</b></p> <p>1. This instruction entirely starts to be implemented on 2025.</p> <p>2. Except from paragraph 1 (one), for the year 2024 a 1 (one) year trial agreement is concluded between the Ministry and the public institution of higher education in order to create the necessary practices and modalities for the effective functioning of the new funding methodology.</p> <p>3. The agreement from paragraph 2 (two) is concluded in accordance with the provisions of this Instruction but which does not affect the amount of the budget allocated by the Law on the Budget for 2024.</p> <p>4. The negotiation for the conclusion of the agreement from paragraph 2 (two) is carried out after the entry into force of this instruction and based on the deadlines and preparatory budget plans for 2024.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Implementation of the other legislation in</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>VIII. PRELAZNE I KONAČNE ODREDBE</b></p> <p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Sprovođenje ovog uputstva</b></p> <p>1. Ovo uputstvo u celini počinje da se primenjuje 2025. godine.</p> <p>2. Osim stava 1 (jedan), za 2024. godinu zaključuje se probni sporazum na 1 (jednu) godinu između Ministarstva i javne institucije visokog obrazovanja u cilju stvaranja potrebne prakse i modalitete za efikasno funkcionisanje nove metodologije finansiranja. .</p> <p>3. Sporazum iz stava 2 (dva) zaključuje se u skladu sa odredbama ovog uputstva, ali ne utiče na visinu budžeta izdvojenog iz Zakona o budžetu za 2024. godinu.</p> <p>4. Pregovori za zaključivanje sporazuma iz stava 2 (dva) sprovode se nakon stupanja na snagu ovog uputstva i na osnovu rokova i pripremnih planova budžeta za 2024. godinu.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Sprovođenje drugih zakona na snazi</b></p>
--	---	---

<p>Për çështjet që nuk janë rregulluar në këtë udhëzim, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat tjera përkatëse që janë të aplikueshme.</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Shtojca e udhëzimit</b></p> <p>Pjesë integrale e këtij udhëzimi është shtojca numër 1 (një) e këtij udhëzimi, e cila përcakton formulën e financimit në bazë të performancës së universiteteve publike;</p>	<p style="text-align: center;"><b>force</b></p> <p>For issues that are not regulated in this instruction, are applied provisions of the legislation in force and other relevant rules that are applicable.</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Appendix of the instruction</b></p> <p>An integral part of this instruction is appendix number 1 (one) of this instruction, which defines the funding formula based on the performance of public universities;</p>	<p>Zapitanja koja nisu regulisana ovim uputstvom, primenjuju se odredbe važećeg zakonodavstva i druga relevantna pravila koja su na primenjiva.</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Aneks uputstva</b></p> <p>Sastavni deo ovog uputstva je Aneks broj 1 (jedna) ovog uputstva, kojim se definiše formula finansiranja na osnovu performanse javnih univerziteta;</p>
---	---	--



## I. SHPJEGIM I PËRGJITHSHËM

**I.** Alokimi i buxhetit të një institucioni të arsimit të lartë përfshin: Alokimin për staf akademik me normë të plotë; Alokimin për personelin administrativ; Alokimin për mallra dhe shërbime, përfshirë shërbimet komunale; Alokimin për shpenzimet kapitale për mirëmbajtje të objekteve; Alokimin për subvencione dhe transfere; Të hyrat vetjake të universiteteve.

**II.** Formula financiare për alokimin e buxhetit të një institucioni të arsimit të lartë përbëhet nga pesë nënformula (kriteret) të cilat përfshijnë buxhetin për: Stafin akademik me normë të plotë; Personelin administrativ; Mallrat dhe shërbimet, përfshirë shërbimet komunale; Shpenzimet kapitale për mirëmbajtje të projekteve; Subvencionet dhe transferet.

## II. CAKTIMI I BUXHETIT PËR STAF AKADEMIK ME NORMË TË PLOTË

### 1. Caktimi i numrit të stafit akademik bëhet në këtë mënyrë:

1.1. Mënyra e llogaritjes së numrit të studentëve si kriter për caktimin e numrit të stafit akademik me normë të plotë:

- *Për secilin program të studimeve llogaritet numri mesatar i studentëve për një vit të studimeve;*
- *Nxirret një mesatare e numrit të orëve mësimore në javë;*
- *Nxirret ngarkesa mesatare javore me orë për studentët e një gjenerate.*

1.2. Numri i studentëve si kriter për caktimin e numrit të stafit akademik me normë të plotë:

- ⇒ *Deri në 50 studentë në gjeneratë është e barasvlershme me 3 (tre) profesor me normë të plotë;*
- ⇒ *Prej 51-99 studentë në gjeneratë përfshin shtimin edhe të 1 (një) profesori me normë të plotë;*
- ⇒ *Për çdo 100 studentë në gjeneratë përfshin shtimin edhe të një 1 (një) profesori me normë të plotë.*

## III. CAKTIMI I BUXHETIT PËR PERSONEL ADMINISTRATIV

**1. Caktimi i numrit të personelit administrativ bëhet në këtë mënyrë:**

1.1. Mënyra e llogaritjes së numrit të studentëve si kriter për caktimin e numrit të personelit administrativ:

- ⇒ *Merret parasysh numri përgjithshëm i studentëve aktiv;*
- ⇒ *Përcaktohet raporti i personelit administrativ në raport me numrin e studentëve;*

1.2. Numri i studentëve si kriter për caktimin e numrit të personelit administrativ:

- ⇒ *Aplikohet kriteri 1 (një) punëtor i personelit për 70 (shtatëdhjetë) studentë.*

**IV. CAKTIMI I BUXHETIT PËR MALLRAT DHE SHËRBIMET,  
PËRFSHIRË SHËRBIMET KOMUNALE**

**1. Caktimi i buxhetit për mallrat dhe shërbimet duke përfshirë edhe shpenzimet komunale bëhet në këtë mënyrë:**

1.1. Mënyra e llogaritjes së buxhetit për mallrat dhe shërbimet duke përfshirë edhe shpenzimet komunale:

- ⇒ *Buxheti për mallra dhe shërbime caktohet si një shumë fikse por që në marrëveshjen e performancës bëhet konkretizimi i buxhetit në kodet e aplikueshme buxhetore për mallra dhe shërbime;*
- ⇒ *Merret parasysh numri i përgjithshëm i studentëve aktiv;*
- ⇒ *Merret parasysh profili i programeve që ofron universiteti sipas koeficientëve të ISCDE-F 2013;*
- ⇒ *Llogaritja bëhet sipas numrit të studentëve aktiv duke pasur parasysh koeficientin sipas tabelës ISCDE-F 2013;*
- ⇒ *Koeficientit të ISCDE-F 2013, i caktohet një vlerë monetare dhe nga kjo caktohet buxheti total për mallra dhe shërbime.*

1.2. Koeficienti për caktimin e buxhetit për mallra dhe shërbime duke përfshirë edhe shpenzimet komunale:

- ⇒ *Vlera e koeficientit caktohet me vendim të Ministrit të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.*

1.3. Klasifikimi i fushave të studimit sipas ISCDE-F 2013 caktohet si më poshtë:

**Kodi**

**Fusha e studimit**

**Koeficienti/kokë studenti**

00	<b>Programe dhe kualifikime gjenerike</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Programe dhe kualifikime bazike</li> <li>• Lakueshmëri dhe numërim</li> <li>• Shkathësi personale</li> </ul>	1
01	<b>Edukimi</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Edukimi i pa specifikuar</li> <li>• Shkenca e edukimit</li> <li>• Trajnimi i mësuesve parashkollor</li> <li>• Trajnimi i mësimeve pa subjekt specializimi</li> <li>• Trajnimi i mësimeve me subjekt specializimi</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me edukimin</li> </ul>	1
02	<b>Artet dhe shkencat humane</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Artet dhe shkencat humane të padefinuara më shumë</li> <li>• Teknikat audio-vizuele dhe prodhimi mediatik</li> <li>• Moda, dizajni interieri dhe industria</li> <li>• Artet e bukura</li> <li>• Puna e dorës (handicrafts)</li> <li>• Muzikë dhe art performues</li> <li>• Religjioni dhe teologjia</li> <li>• Historia dhe arkeologjia</li> <li>• Filozofia dhe etika</li> <li>• Gjuha</li> <li>• Letërsia dhe linguistika</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me gjuhën dhe shkencat humane</li> </ul>	1
03	<b>Shkencat sociale, gazetari dhe informacion</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkencat sociale të pa specifikuar më shumë</li> <li>• Ekonomia</li> </ul>	1

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkencat politike</li> <li>• Psikologjia</li> <li>• Sociologjia dhe studimet kulturore</li> <li>• Gazetaria dhe raportimi</li> <li>• Studime për biblioteka, informacion dhe arkiv</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me shkencat sociale, gazetari dhe informacion</li> </ul>	
04	<p><b>Biznes, administratë dhe ligj</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Biznes dhe administratë e paspecifikuar më shumë</li> <li>• Kontabilitet dhe taksa</li> <li>• Financa, banka dhe sigurime</li> <li>• Menaxhment dhe administrim</li> <li>• Marketing dhe reklamim</li> <li>• Punë administrative</li> <li>• Shitje me shumicë dhe pakicë</li> <li>• Shkathtësi pune</li> <li>• Juridike</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me biznes, administratë dhe ligj</li> </ul>	1
05	<p><b>Shkencat natyrore, matematikë dhe statistikë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkencat natyrore, matematikë dhe statistikë të paspecifikuara më shumë</li> <li>• Biologji</li> <li>• Biokimi</li> <li>• Shkencat e mjedisit</li> <li>• Ambienti natyror dhe bota e egër</li> <li>• Fizikë</li> <li>• Kimi</li> <li>• Shkencat e tokës</li> </ul>	1.2

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Matematikë</li> <li>• Statistikë</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me shkencat natyrore, matematikë dhe statistikë</li> </ul>	
06	<p><b>Informacion dhe teknologji e komunikimit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Informacion dhe teknologji e komunikimit e specifikuar më shumë</li> <li>• Përdorimi i kompjuterit</li> <li>• Databaza, dizajni dhe administrimi i rrjeteve</li> <li>• Softuerët dhe zhvillimi i aplikacioneve</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me informacionin dhe teknologjinë e komunikimit</li> </ul>	1.2
07	<p><b>Inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari të paspecifikuara më shumë</li> <li>• Inxhinieri dhe tregti inxhinierike</li> <li>• Inxhinieri kimike</li> <li>• Teknologji për mbrojtjen e ambientit</li> <li>• Elektro dhe energji</li> <li>• Elektronikë dhe automatikë</li> <li>• Mekanika dhe metalet</li> <li>• Motorët, makinat, anijet dhe aeroplanët</li> <li>• Prodhimtaria dhe procesimi</li> <li>• Procesimi i ushqimit</li> <li>• Materialet (xham, letër, plastikë dhe dru)</li> <li>• Tekstili (rrobat, mbathjet dhe lëkura)</li> <li>• Xehetaria dhe minierat</li> <li>• Arkitektura dhe ndërtimtaria</li> </ul>	2

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura dhe planifikimi urban</li> <li>• Ndërtimi dhe inxhinieria civile</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me inxhinieri, prodhim dhe ndërtimtari</li> </ul>	
<b>08</b>	<b>Agrikultura, pylltaria, peshkimi dhe veterinaria</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Agrikultura</li> <li>• Prodhimi i bimëve dhe kultivimi i kafshëve</li> <li>• Hortikultura</li> <li>• Pylltaria</li> <li>• Peshkimi</li> <li>• Veterinaria</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me agrikulturën, peshkimin dhe veterinarinë</li> </ul>	1.5
<b>09</b>	<b>Shëndeti dhe mirëqenia</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stomatologjia</li> <li>• Mjekësia</li> <li>• Infermiera</li> <li>• Diagnostikimi mjekësor dhe teknologjia për shërim</li> <li>• Terapi dhe rehabilitim</li> <li>• Farmaci</li> <li>• Përkujdesi mjekësor</li> <li>• Kujdesi ndaj të moshuarve dhe të rriturve me aftësi të kufizuara</li> <li>• Kujdesi ndaj fëmijëve dhe shërbimet ndaj të rinjve</li> <li>• Puna sociale dhe këshillimi</li> <li>• Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me shëndetin dhe mirëqenien</li> </ul>	1.5
<b>10</b>	<b>Shërbimet</b>	1.5

- Shërbime në shtëpi
- Shërbime për flokë dhe estetikë
- Hotelieri, restorante dhe kuzhine
- Sportet
- Udhëtim, turizëm dhe rekreacion
- Higjiena dhe shërbime mbi shëndetin profesional
- Pastërtia në komunitete
- Siguria dhe shëndeti në punë
- Shërbime rreth sigurisë
- Ushtri dhe mbrojtje
- Mbrojtja e personave dhe pasurisë
- Shërbime të transportit
- Programet dhe kualifikimet interdisiplinare që ndërlidhen me shërbimet

## V. CAKTIMI I BUXHETIT PËR SHPENZIMET KAPITALE PËR MIRËMBAJTJE TË OBJEKTEVE

### 1. Caktimi i buxhetit për shpenzimet kapitale për mirëmbajtje të objekteve:

1.1. Mënyra e llogaritjes së buxhetit për shpenzimet kapitale për mirëmbajtje të objekteve:

- ⇒ *Mirëmbajtja nënkupton kryerjen e veprimeve për ruajtjen dhe avancimin e funksionit të objekteve dhe pajisjeve kapitale që bëjnë pjesë në kategorinë e shpenzimeve kapitale;*
- ⇒ *Merret parasysh sipërfaqja në metra katror i objekteve të universitetit;*
- ⇒ *Kostoja për shpenzimet kalkulohet për metër katror të hapësirës së shfrytëzueshme të objekteve në formë të shumës fikse;*

1.2. Koeficienti për caktimin e buxhetit për shpenzimet kapitale për mirëmbajtje të objekteve:

- ⇒ *Vlera e koeficientit caktohet me vendim të Ministrisë të Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit*

## VI. CAKTIMI I BUXHETIT PËR SUBVENCIONE DHE TRANSFERE

### 1. Caktimi i buxhetit për subvencione dhe transferë:

#### 1.1. Qëllimi dhe mënyra e llogaritjes së buxhetit për subvencione dhe transferë:

- ⇒ *Shpërblehen/stimulohen stafit akademik dhe studentët për sukseset e dalluara (ndahen bursat për studentët dhe subvencionohet puna kërkimore shkencore e stafit akademik);*
- ⇒ *Merret parasysh numri i përgjithshëm i studentëve aktiv;*
- ⇒ *Merret parasysh numri i përgjithshëm i personelit akademik;*

#### 1.2. Numri i personelit akademik dhe studentëve si kriter për caktimin e buxhetit për subvencione dhe transferë:

- ⇒ *Ndahen 25 euro për një student;*
- ⇒ *Ndahen 100 euro për një anëtar të stafit akademik.*

## VII. CAKTIMI I BUXHETIT PËR FINANCIMIN E PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE

### 1. Caktimi i buxhetit për financimin e punës kërkimore-shkencore bëhet në këtë mënyrë:

#### 1.1. Mënyra e llogaritjes së buxhetit për mbështetjen e projekteve kërkimore-shkencore (neni 19):

- ⇒ *Buxheti për mbështetjen e projekteve kërkimore-shkencore caktohet duke u bazuar në totalin e shpenzimeve për projekte kërkimore-shkencore që janë realizuar në tre vitet e mëparshme. Megjithatë, kufiri maksimal i buxhetit që mund të alokohet nuk mund të tejkalojë 5% të buxhetit total të dedikuar për stafin akademik dhe personel administrativ (pagat dhe shtesat).*
